



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 347/5 Prot.

Tiranë, më 17.05.2016

V E N D I M

Nr. 56, datë 17/05/2016

“Për përfundimin e procesit të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 63, datë 02.07.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 22, datë 11.03.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar inspektimi i përgjithshëm në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 63, datë 02.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pjesë e këtij vendimi.
2. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e

vlerësimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të inspektimit, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore dhe për të evituar subjektivizmin në nivelin e vlerësimit.

Në vijim, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të Vendimit nr. 63, datë 02.07.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”*, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe në Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Procesi i mbikëqyrjes në vazhdim ka filluar bazuar në Vendimin nr. 46, datë 20.04.2016, të Komisionerit, me ngritjen e grupit të punës, i cili u paraqit në subjektin e mbikëqyrur në datën 06.05.2016 dhe kyqri dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kishte përfunduar hartimin e formularëve të punës për çdo pozicion pune, të administruar në dosjet e personelit dhe të nënshkruar rregullisht nga nëpunësit përkatës dhe eprorët direkt të tyre, duke pranuar njohjen dhe dakordësinë me dokumentin në fjalë.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2, të pjesës urdhëruese të Vendimit nr. 63, datë 02.07.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”*, rezultoi se formularët e vlerësimit të rezultateve në punë ishin plotësuar në seksionin e shënimeve në rubrikat përkatëse, duke pasqyruar komentet në gjithë zërat e kërkuar nga formularët e vlerësimit në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.2.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar.

Sa më sipër, konkludoj se Vendimi nr. 63, datë 02.07.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është zbatuar plotësisht nga ana e subjektit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Përfundimin e procesit të inspektimit të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 63, datë 02.07.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm të administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”*.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA